

# KEMI GJITHMONË ENERGJI POZITIVE



# DEMOKRACIA ËSHTË LIRIA PËR TË ZGJEDHUR LIRSHËM, JO NË MËNYRË TË IMPONUAR

DINETA (10), MIRGENA (11), LABRIK (11), XHENETA (10), DENIS (11), ALBIN (11)



## Demokracia buron nga vullneti i mirë i popullit. Se kur lindi ajo dhe cili është populli i parë që e jetësoi këtë sistem, iu informon artikulli ynë

Gjërat që kanë vlerë të madhe kanë edhe jetëgjatësi të madhe. Për të ilustruar më së miri këtë, e kemi shembullin e demokracisë. Ajo daton qysh nga viti 507 para erës sonë. Pra, janë shumë vite, dekada dhe shekuj që kur ky sistem zuri një vend shumë të rëndësishëm tek qytetarët. Nga viti kur u paraqit për herë të parë e deri në ditët e sotme, qëllimi kryesor i tij kurrë nuk ndryshoi. E ky qëllim është udhëheqja nga ana e popullit. Në fakt kjo gjë, udhëheqja e popullit, ka ardhur çdo herë duke u bërë më e kërkueshme. Ashtu siç ne në përditshmërinë tonë i kërkojmë gjërat që na mungojnë, ashtu edhe shtetet që nuk kanë pasur demokracinë si sistem filluan të bënin thirrje për këtë sistem. Ka arsye të ndryshme pse demokracia kërkohet shumë nga qytetarët. Ne po përmendim disa. Janë respekti, toleranca, barazia, paqja, liria e shumë e shumë të tjera elemente që demokracisë veçse ia shtojnë vlerën. Teksa jemi tek elementet e demokracisë, dëshirojmë të tregojmë një ngjarje nga jeta jonë.

Ne kemi një shoqe shumë të mirë, e cila fatkeqësisht ka pasur pak probleme me shokët dhe shoqet e saj të ngushtë. Ata filluan ta injoronin atë dhe nuk shqëroheshin me të. Kjo sjellje vinte për shkak se familja e shoqes sonë po kalonte në një fazë të vështirë financiare. Kur ne e kuptuam se çfarë po ndodhte, filluam t'i qëndronim asaj afër duke e përkrahur dhe duke i

thënë asaj fjalë inkurajuese, në mënyrë që të ndihej më mirë. Ne kështu u bëmë shokët e saj të rinj. Pra, ne si grup, vullnetarisht jemi mbledhur që t'i ndihmojmë shoqes sonë. Për neve është shumë e rëndësishme që e gjithë shoqëria jonë të jetë mirë. Kjo është edhe çka kërkon demokracia nga qytetarët. Ky ishte një shembull i thjeshtë për të kuptuar në një farë mënyre edhe rolin e veçantë të qytetarëve në demokraci.


Pra, duke u nisur nga vepra shumë të vogla ato arrijnë të bëhen të mëdha. Ashtu siç demokracia që ka filluar me një shtet e tash ajo është pjesë e shumicës së shteteve në botë. Këtu hyn edhe vendi ynë, Kosova. Edhe ne jemi vend demokratik, ku populli ka rolin kryesor. Në vendin tonë kemi demokraci përfaqësuese, ngase qytetarët me vota të lira zgjedhin përfaqësuesit e tyre. E tëra që është shkruajtur në artikull është hallkë e demokracisë. Po të mos ishte demokracia, kjo hallkë as nuk do të ekzistonte. A pajtoheni edhe ju me këtë mendim?



Ju dhurojmë dashuri për leximin e artikullit tonë

# ZHVILLIMI VIE NGA QYTETARËT AKTIV

AID (10), ANES (10), SHKRONJA (10), ARTA (10), MARIGONA (10), VERONA (10)



## Ne pjesëtarët e grupit tonë kemi menduar që të hapim një organizatë joqeveritare e cila do të ketë për synim humanizmin

Në demokraci element i rëndësishëm është barazia në mes të gjithë qytetarëve. Për ta arritur këtë barazi, të gjithë duhet ta ndihmojmë njëri-tjetrin pa dallime. Pothuajse në çdo vend ku qytetarët jetojnë ka dallime në mes të kushteve të tyre ekonomike. Kjo nënkupton se disa janë më të pasur e disa të tjerë më pak. Duke



Po, po ne jemi aktiv. Po ju?

u nisur nga kjo dhe nga vlera kyçe e demokracisë që është barazia, ne kemi menduar të krijojmë një grup vullnetarësh, të cilët do të kontribuonin për familjet me gjendje të rënduar ekonomike. Kështu ne duam që të themelojmë një organizatë joqeveritare me qëllime bamirësie. Me anë të kësaj organizate, do të mbledhim fonde nga bizneset e mëdha, organizatat ndërkom-bëtare dhe kompanitë e ndryshme. Me ato fonde do të

përpiqemi të sigurojmë një jetë normale për qytetarët me gjendje të rëndë ekonomike. Kështu ne do të jemi shumë hapa më afër këtyre familjeve, të cilat përbal-len në vazhdimësi me sfida të rënda. Ky veprim tregon se ne duam të jemi qytetarë aktiv. E qytetaria aktive është veprimtari e cila përbëhet nga vullneti dhe dësh-hira e qytetarëve për të kontribuar për shtetin e tyre dhe për qytetarët e tjerë.

Nëse dëshironi të dini edhe ju fëmijë se çka tjetër bëjnë qytetarët aktiv, atëherë ne do t'iu tregojmë.

Qytetarët aktiv bëjnë punë vullnetare, informohen drejt, i ndajnë njohuritë e tyre me të tjerët, marrin pjesë në procesin zgjedhor, marrin pjesë në tubimet e ndrysh-me publike, respektojnë ligjet, mbajnë pastër ambi-entnin, respektojnë njëri-tjetrin, etj. Tërë këto veprime i bëjnë nga dëshira dhe vullneti i madh që kanë në zemrat e tyre për ndryshim. Gjithsesi, ju mund të gjeni edhe mënyra të tjera për të shfaqur këtë dëshirë.



Qytetarë të përgjegjshëm dhe të këndshëm







Vlera më e madhe e Tokës jemi ne




Nëse dijme t'i respektojmë vlerat e demokracisë




Këto janë disa nga të drejtat tona, që mbrohen me ligje



Të miratuara në mënyrë demokratike, me vota të deputetëve




Ky është një ndër përfaqësuesit tanë, i cili punon për neve



Ata iu përkasin partive të ndryshme politike

# ZGJEDHJA ËSHTË E JONA

FLETA (10), ERIT (10), YLL (11), ALMIR (11), ERION (11), ERËZA (11)



**Nuk mund ta merni me mend se sa të lumtur jemi që sot patëm rastin të jemi gazetarë. Andaj, me shumë përkushtim dhe entuziazëm e shkruajtëm këtë artikull mbi zgjedhjet**

Lënda e edukatës fizike na pëlqen shumë. Një ditë bashkë me mësuesen tonë, dolëm jashtë për të zhvilluar këtë orë. Ne zgjodhëm që të luajmë futboll. Meqë u ndamë në dy ekipe, secili ekip duhej të kishte një kapiten/e përkatëse. Kështu, vendosëm që kapitenët t'i zgjedhim në mënyrën më demokratike. Kjo mënyrë pa dyshim se është përmes votave.

Një shembull tjetër ku ne kemi votuar është edhe rasti kur zgjodhëm kryetaren e klasës sonë. Së pari, secili nxënës votoi për shokun ose shoqen e preferuar, e pastaj me shumicë votash u zgjodh kryetarja e re e klasës.

Për të votuar në shembujt e lartpërmendur nuk duhet të kemi arritur moshën 18 vjeçare. Mirëpo, për të marrë pjesë në procesin zgjedhor duhet të jemi mbi

18 vjet. Kjo për shkak se ky proces është tejet i rëndësishëm për të gjithë qytetarët e vendit. Andaj, kërkohet nga ne që të jemi të pjekur dhe të mendojmë mirë para se t'i a besojmë votën tonë dikujt. Vota është e drejtë dhe përgjegjësi e të gjithë qytetarëve të cilët jetojnë në demokraci. Për këtë arsye, ajo nuk duhet të imponohet dhe secili duhet të votoj duke u bazuar vetëm në mendimin e vet personal.

Zgjedhjet me rregull duhet të ndodhin çdo 4 vjet. Ato mund të ndodhin më herët në raste të jashtëzakonshme. Por, asnjëherë nuk duhet të kalojnë më shumë se 4 vjet pa pasur zgjedhje.

Nuk duhet të harrojmë t'i përmendim as dy llojet e zgjedhjeve të cilat janë: zgjedhjet qendrore ku i zgjedhim përfaqësuesit tanë në Kuvend e të cilët janë deputetët; si dhe zgjedhjet komunale ku i zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse dhe asamblistët. Qytetarë të nderuar, ju lutem votoni, sepse vota juaj është e rëndësishme për popullin tonë.



Gazetarët më simpatikë



Po ju, cilën do të zgjedhni?





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Ganimete Tërbeshi“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Llukar, Prishtinë